



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**VENDIM**

**Nr. 63, datë 24.02.2021**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT  
Z.{...}, PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE NË GJYKATËN E  
POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E  
ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe në pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr.240 prot., datë 23.02.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr.5980, datë 27.11.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal”.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**